



Republika e Kosovës

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Përmbledhje Ekzekutive

**KORNIZA E MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
(KMMS)**

Projekti:

Projekti për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës

Projekt ID: P179656

Tetor, 2023

Përmbledhje Ekzekutive – Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS)

Hyrje

Qeveria e Kosovës (QK) përmes Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve synon të marrë fonde nga Banka Botërore (BB) për zbatimin e Projektit për “Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës”. Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së shërbimeve të zhvillimit të fëmijërisë së hershme në Kosovë. Projekti për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme (ZHFH) për Kapitalin Njerëzor të Kosovës është i strukturuar për t’iu përgjigjur çështjeve kryesore të shërbimeve të zhvillimit të fëmijërisë së hershme në Kosovë. Projekti do të ndihmojë Kosovën të përmirësojë aksesin, cilësinë dhe barazinë në ZHFH, si dhe të mbështesë shërbimet e kujdesit shëndetësor në adresimin e sfidave shëndetësore të fëmijëve në vend. Projekti gjithashtu do të shqyrtojë aktivitetet promovuese në ZHFH me qëllim që të rrisë ndërgjegjësimin e popullatës për rëndësinë e ZHFH në kuadër të shëndetit dhe zhvillimit të fëmijëve, duke sjelle si rezultat një prindërim më të mirë, identifikim të hershëm dhe ulje të shkallës së vdekshmërisë së fëmijëve. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) është agjencia kryesore zbatuese për përgatitjen e projektit dhe aktiviteteve përkatëse, dhe do të identifikojë kërkesat e menaxhimit mjedisor dhe social për fazën përgatitore të projektit.

Qëllimi i hartimit të Kornizës së Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS)

Qëllimi kryesor i KMMS është të shmangë, minimizojë ose zbusë ndikimet e mundshme negative mjedisore dhe sociale të lidhura me zbatimin e projektit. Është zgjedhur qasja Kornizë pasi projekti financon një gamë të gjerë aktivitetesh të vogla/mesme, rehabilitimin, ripërdorimin e hapësirave ekzistuese si dhe ndërtimin e kopshteve të reja, shumica e të cilave nuk janë ende të identifikuar dhe pritet të saktësohen kur të fillojë zbatimi i projektit. Kjo kornizë KMMS siguron që nënprojektet që do të identifikohen në kuadër të projektit për ZHFH, të jenë vlerësuar saktë nga pikëpamja mjedisore dhe sociale në përputhje të plote me Kornizën Mjedisore dhe Sociale të BB-së (ESF) dhe standardet e saj të aplikueshme, si dhe me ligjet dhe rregulloret mjedisore dhe sociale të Kosovës për zbutjen e ndikimeve të mundshme dhe/ose ndikimet e pashmangshme. Korniza shërben si një mjet udhëzues për Njësinë e Zbatimit të Projekteve (NjZP) nën Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), e cila mban rolin e agjencisë zbatuese. Veç këtij dokumenti, në kontekstin e projektit janë hartuar dhe planet e tjera shoqëruese, që përfshijnë Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP), Kornizën e Politikave të Zhvendosjes (KPZH), Procedurat e Menaxhimit të Punës (LMP) dhe Planin e Angazhimit Mjedisor dhe Social (ESCP).

Përshkrimi i Projektit dhe Komponentëve të tij

Objektivi i zhvillimit të projektit për ZHFH, është përmirësimi i qasjes së barabartë dhe rritja e cilësisë së shërbimeve të zhvillimit të fëmijërisë së hershme në Kosovë. Rezultatet kryesore të pritura nga zbatimi i projektit do të vlerësohet nga indikatorët që përbëhen nga:

Indikator 1: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të edukimit në fëmijërinë e hershme – të kategorizuara sipas llojit të institucionit urban/rural

Indikator 2: Rregullore të përmirësuara për sigurimin e cilësisë së shërbimeve të fëmijërisë së hershme në Kosovë

Indikator 3: Përqindja e fëmijëve të vlerësuar sipas programit/mjetit kombëtar të zhvillimit dhe monitorimit të fëmijëve

Indikator 4: Rritja e çasjes në shërbimet e kujdesit për fëmijët: shkalla e regjistrimit për fëmijët 0-6 vjeç – e ndarë sipas gjinisë, moshës, grupit të pakicës

Projekti i propozuar do të organizohet rreth katër komponentëve kyç që kanë të bëjnë me përmirësimin e çasjes, cilësisë, barazisë dhe koordinimit ndërsektorial të shërbimeve për ZHFH. Komponenti i parë do të forcojë cilësinë dhe barazinë e shërbimeve për ZHFH dhe kujdesin ndaj fëmijëve në Kosovë. Komponenti i dytë do të kontribuojë në përmirësimin e disponueshmërisë së shërbimeve shëndetësore dhe ushqimore për fëmijët dhe familjet në Kosovë. Komponenti i tretë do të fokusohet në rritjen e aksesit në ZHFH dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Komponenti i katërt do të mbështeste menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

Komponentët e projektit do të kenë një ndikim në nivel kombëtar dhe në nivel shkollor. Komponentët 1 dhe 2 do të kenë një shkallë mbarëkombëtare duke reformuar qasjen ndaj kujdesit të fëmijëve dhe shërbimeve për ZHFH, duke ndërtuar kapacitetet institucionale dhe njerëzore të vendit. Komponenti 3 do të ketë ndërhyrje në nivel shkolle duke ndërtuar, rinovuar dhe ripërdorur hapësira për të zgjeruar aksesin për ciklin parashkollor në të gjithë vendin. Komponenti 4 do të ndihmojë në ndërtimin e kapaciteteve eksperte të Kosovës në menaxhimin e projekteve dhe kryerjen e hulumtimit, monitorimit dhe vlerësimit.

Komponenti 1: Forcimi i cilësisë dhe barazisë së shërbimeve për ZHFH në Kosovë.

- ✓ Nën komponenti 1.1 Reformat e cilësisë në ZHFH në Kosovë
- ✓ Nën komponenti 1.2. Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për ZHFH
- ✓ Nën komponenti 1.3. Implementimi i modulit ECE për Sistemin Informativ të Menaxhimit të Arsimit (EMIS) në Kosovë dhe rishikimi i përgjithshëm i sistemit bazë EMIS.

Komponenti 2: Nxitja e integritit shumë-sektorial në ofrimin e shërbimeve për ZHFH

- ✓ Nën komponenti 2.1. Stimulimi i hershëm dhe promovimi i ushqyerjes së shëndetshme
- ✓ Nën komponenti 2.2. Monitorimi i fëmijëve dhe integrimi ndërsektorial i shërbimeve

Komponenti 3: Rritja e aksesit në shërbimet e ZHFH

- ✓ Nën komponenti 3.1. Ripërdorimi, ndërtimi dhe rinovimi i objekteve parashkollore dhe të ZHFH në Kosovë
- ✓ Nën komponenti 3.2. Pajisja e qendrave për ZHFH me mobilje dhe materiale të reja mësimore
- ✓ Nën komponenti 3.3. Mbështetje për pjesëmarrjen e komunitetit dhe ndërhyrjet nga ana e kërkesës

Komponenti 4: Menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i projektit

Politikat, Rregulloret dhe Ligjet Mjedisore dhe Sociale

Korniza ligjore mjedisore e Kosovës është e rëndësishme për aktivitetet e përgjithshme të projektit, dhe veçanërisht aktivitetet nën komponentin 3, që përfshin gjithashtu financimin e ndërhyrjeve të shkallës së mesme, si rehabilitimin dhe ripërdorimin e hapësirave ekzistuese, si dhe ndërtimin e kopshteve të reja, vendndodhja e të cilave do të identifikohet në fillimin e fazës së zbatimit të projektit. Ndërkohë, korniza ligjore dhe politikat sociale, janë të rëndësishme për komponentët e përgjithshëm të projektit. Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis do të respektohet dhe do të ndiqet për nënprojektet që do t'i nënshtrohen Vlerësimit Kombëtar Mjedisor dhe Social dhe marrjes së Lejeve përkatëse. Në lidhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale të BB-së, rreziku mjedisor dhe social i Projektit vlerësohet të jete i nivelit të mesëm dhe projekti do të përfshijë standardet e mëposhtme të zbatueshme të ESF-së, përkatësisht ESS 1 Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale, ESS 2 Puna dhe Kushtet e Punës, ESS 3 Efikasiteti i burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes, ESS 4 Shëndeti dhe Siguria në Komunitet, ESS 5 Blerja e tokës, Kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme, dhe ESS 10 Angazhimi i palëve të interesuara dhe zbulimi i informacionit; si dhe Udhëzimet për Shëndetin dhe Sigurinë Mjedisore të Grupit të Bankës Botërore.

Vendndodhja dhe shtrirja e projektit

Projekti i propozuar ka mbulim në nivel kombëtar dhe përfshin kufijtë administrativë të Republikës së Kosovës. Vendndodhja për ndërtimin e kopshteve të reja nuk janë caktuar ende në këtë fazë paraprake dhe do të detajohet pasi projekti të fillojë implementimin, gjithsesi pritet që ndërtimi i kopshteve të reja të bëhet kryesisht në toka publike, të cilat janë caktuar për këtë qëllim sipas planeve të zhvillimit dhe janë në pronësi, ose i janë transferuar përfituesit përkatës.

Vlerësimi Paraprak i përgjithshëm i ndikimeve mjedisore dhe sociale

Niveli i ndikimeve negative mjedisore dhe sociale të projektit të cilat do të lidhen kryesisht me fazën e zbatimit të punimeve të parashikuara sipas komponentit 3, vlerësohet të jete i mesëm, ndërkohe që ndikimet e përgjithshme të pritshme nga implementimi i plote të projektit pritet të jene pozitive. Zbatimi i punimeve sipas komponentit 3, mund të shoqërohen me impakte mjedisore dhe sociale të mesme. Te karakterit të përkohshëm dhe lokal, të cilat mund të shmangen apo të zvogëlohen lehtësisht nëpërmjet aplikimit të masave mbrojtëse sipas udhëzimeve të standardeve të BB, politikave të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë të BB si dhe respektimit të kuadrit ligjor mjedisor dhe social të republikës së Kosovës. Impakti kryesor social i cili duhet të mbahet parasysh gjatë zbatimit të projektit në mënyrë që të shmangët maksimalisht, lidhet dhe riskun e mos përfshirjes së grupeve në nevojë dhe të disavantazhuar, duke mos i dhënë mundësinë të përfitojnë nga projekti.

Procedurat dhe organizimi i zbatimit.

Duke qenë se zbatimi i projektit kërkon përfshirje shumë-sektoriale, pika qendrore e qeverisë për kapitalin njerëzor, MASHTI do të jete një lojtar kyç që do të mund të bashkojë të gjitha ministritë dhe agjencitë e përfshira dhe të interesuara, për të arritur rezultatet e projektit. MASHTI do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm, koordinimin, monitorimin e rezultateve dhe komunikimin me BB-në për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura me projektin. Një Njësi Qendrore për zbatimin e Projektit (NjZP) do të krijohet brenda MASHTI-it. Roli kryesor i NjZP-së do të jete ofrimi i asistencës teknike dhe operacionale për MASHTI-n dhe Qarqet/Komunitat e synuara në zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë funksione si prokurimin,

menaxhimin financiar dhe do te mbaj përgjegjësinë e menaxhimit të ndikimeve mjedisore dhe sociale. Për të përmirësuar kapacitetet institucionale në lidhje me zbatimin e KMMS, Specialistët Mjedisor dhe Social të BB do të ofrojnë trajnime të posaçme për stafin e NjZP dhe MASHTI-n të fokusuar në: (i) Aspektet procedurale të vlerësimeve paraprake mjedisore dhe sociale (fazat, aktorët kryesorë, përgjegjësitë kryesore etj.); (ii) Vlerësimi i ndikimeve mjedisore dhe sociale që mund të lidhen me nënprojektet në kuadër të projektit; (iii) Konsultimi dhe miratimi i VNM-ve dhe planeve të monitorimit; dhe (iii) përgatitja e listës kontrolluese të planit të menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS); (iv) Kryerja e mbikëqyrjes në terren dhe përgatitja e raporteve të progresit.

Angazhimi i palëve të interesit, dhe zhvillimi i konsultimeve publike.

Ky raport KMMS si dhe dokumentat mjedisore dhe sociale shoqëruese të projektit si SEP, LMP, KPZH dhe Plani i Angazhimit Mjedisor dhe Social (ESCP), pasi të miratohet dhe nga BB, do të postohen në faqet zyrtare të MASHTI-t. Versioni përfundimtar i ESMF do t'i dorëzohet zyrtarisht Bankës Botërore për ta publikuar atë në anglisht, në faqen e jashtme të BB-së. Në ueb faqen zyrtare të MASHT do të postohen versionet në anglisht, shqip dhe serbisht. Versioni përfundimtar i këtij dokumenti do të përdoret nga agjencitë përkatëse qeveritare dhe palët e tjera të interesit gjatë zbatimit të projektit. Nëse gjatë konsultimeve do të kete komente apo reagimet ndaj dokumentit KMMS që do publikohet, ato do të merren në konsideratë dhe do të shtohen si aneks në versionin përfundimtar. MASHT-i NjZP do të kryejë konsultime publike kombëtare/lokale mbi këtë draft ESMF dhe do të ftojë të gjitha organizatat e interesuara duke përfshirë përfaqësuesit vendorë dhe organeve të tjera qeveritare, sipas udhëzimeve të SEP të projektit ECD.